



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1013/18

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Drita Rexhaj, kryetare e kolegjit, Albert Zogaj dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike civile të paditësit A.T. nga fsh. ... - Lipjan, përfaqësuar nga E.A. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, përfaqësuar nga F.M., avokate publike, për shkak të kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.158/16, i datës 24.01.2018, në seancën jo publike të mbajtur me datë 11.09.2020, mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.158/16, i datës 24.01.2018, VËRTETOHET

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.158/16, i datës 24.01.2018, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit A.T. nga fsh. ..., si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Lipjanit, që paditësit t'ia kompensoj të ardhurat personale duke filluar nga data 29.05.2014 e deri me datën 31.08.2014 shumën prej 1.805.73 Euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit 24.01.2018 e deri te pagesa definitive, si dhe në të njëjtën kohë t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 643 Euro, e të gjitha këto në afat prej 7 dite, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të

aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset, dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.T. përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit, që t'ia kompensoj të ardhurat personale duke filluar nga data 29.05.2014 e deri me datën 31.08.2014 shumë prej 1.805.73 Euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit 24.01.2018 e deri te pagesa definitive, si dhe në të njëjtën kohë t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 643 Euro, e të gjitha këto në afat prej 7 dite, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.158/16, i datës 24.01.2018, me të cilin ka vendosur që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit me përmbajtje si në dispozitiv të aktgjykimit, i përshkruar edhe me lartë në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse në procedurë, dhe administrimit të provave e të cilave gjykata iu fali besimin, erdhi në përfundim se paditësi ka filluar punën nga dt. 01.04.2010 si Drejtor i Gjimnazit "Ulpiana" në Lipjan me mandat 4 vjeçar të cilit i ka skaduar më 01.04.2014 dhe i njëjti nuk është rizgjedhur në pozitën e drejtorit, mirëpo në Shtator të vitit 2014 është sistemuar si profesor i lëndës së historisë në Gjimnazin "Ulpiana" në Lipjan, i kualifikuar në këtë lëmi, fakte këto jokontestuese mes palëve. Kontestuese mes palëve ka qenë fakti i mos realizimit të të ardhurave nga dt.29.05.2014 deri me 31.08.2014, ngase sipas Udhëzimit Administrativ nr. 8/14 mbi Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit në Institucionet Edukativo- Arsimore i cili është nxjerrë ne Shkurt te vitit 2014, në nenin 9 është paraparë se Drejtor i Shkollave Edukativo Arsimore të cilët zgjidhen dhe vijnë nga Institucionet Edukativo Arsimore ju ruhet vendi i mëparshëm i punës. Andaj, bazuar në këtë akt ligjor e paditura me të drejtë e ka sistemuar në vendin e punës, profesor i lëndës së historisë në Gjimnazin "Ulpiana" në Lipjan, në Shtator të vitit 2014. Ndërsa për periudhën kontestuese që është lëndë e padisë kompensimin e të ardhurave, gjykata e ka aprovuar në bazë të Udhëzimit Administrativ të përmendur më lartë dhe vendimit të Inspektionit të Arsimit ne Ferizaj nr. 2/410 te dt. 22.10.2014 ku është parapare se paditësi gëzon të drejtën e këtyre mjeteve, kjo gjykatë vendosi të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit dhe ta detyroj të paditurën që t'ia kompensoj të ardhurat për periudhën kontestuese në bazë te mendimit te ekspertit financiar më hollësisht siç është vendosur në dispozitiv të

aktgjykimit. Për bazën juridike gjykata e shkallës së parë ka vendosur konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.8/14, nenit 8 par 1 dhe nenit 136 të LMD-së, për kamatën është konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës konform nenit 452 dhe 453 të LPK –së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat gjykata nuk i shikon sipas detyrës zyrtare por me pretendimin e palës ankuese. Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, nga se, sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërtënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsyesimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

E drejta materiale është aplikuar në mënyrë drejtë në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale nga se gjatë periudhës kohore nga data 28.05.2014 deri me dt. 31.08.2014 paditësi nuk ka punuar tek e paditura nga kjo bazë i mungon baza juridike për kompensimin e të ardhurave të cilat paditësi i ka kërkuar, Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, nga se me nenin 9 Udhëzimit Administrativ nr. 8/14 mbi Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit në Institucionet Edukativo- Arsimore i cili është nxjerrë në Shkurt të vitit 2014, është paraparë se Drejtor i Shkollave Edukativo Arsimore të cilët zgjidhen dhe vijnë nga Institucionet Edukativo Arsimore ju ruhet vendi i mëparshëm i punës. Duke iu referuar dispozitës së lartpërmendur, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të punës, raste të tilla mund të jene edhe kur një punë ka përfunduar dhe pritet fillimi i punës tjetër të kontraktuar, këtë fakt e ka konfirmuar edhe i padituri, duke i

lidhur kontratën e punës paditësit në Shtator të vitit 2014, *andaj* pretendimet ankimore të së paditurës se kemi të bëjmë me një marrëdhënie të ndërprerë pune dhe se paditësit i mungon baza juridike për kompensim, në rastin konkret nuk qëndrojnë.

Përkitazi me lartësinë e aprovuar të kërkesëpadisë për të vërtetuar lartësinë e të ardhurave personale për periudhën kontestuese prej 29.05.2014 deri më dt. 31.08.2014 gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën financiare të datës 30.11.2017, të punuar nga eksperti financiar A.G., nga ka rezultuar se lartësia e të ardhurave personale që kishte me i realizuar paditësi për periudhën prej 29.05.2014 e deri me dt.31.08.2014 së bashku me kamatën ligjore është në lartësi prej 1.805.73 euro, ashtu siq me të drejtë ka vendosur edhe gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e kundërshtuar.

Nga te cekurat me larte kjo gjykatë vlerëson se përfundimi për themelësinë e kërkesëpadisë gjen mbështetje në dispozitën e nenit 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se *“ kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensoi, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, dhe nenit 262 paragrafi 1, ku përcaktohet së: *“kreditori në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit kurse debitori është detyruar që ta përmbushë detyrimin me ndërgjegje sikundër është përmbajtja e tij”*, ashtu siq drejtë ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është në harmoni me dispozitat e LPK-së, dhe rrjedhimisht edhe me lartësinë e shpenzimeve të cilat i pranohen palës paditëse, në këtë rast për përfaqësim, taksa gjyqësore dhe për ekspertizë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura nga Gjykata e Apelit ,gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1013/18 të datës 11.09.2020,

Kryetare e Kolegjit

Drita Rexhaj